

SERIA E BOTIMEVE ELITE

Diaspora Shqiptare

WORCESTER,
MA_Intervista
2004

Bashkëbisedim i hapur me lexuesit shqiptarë për jetën në mërgim.

Kronika e mërgimit të shqiptarëve gjatë shekujve, fillimisht nëpër vende të ndryshme euroaziatike, dhe, më pasë, në Amerikë, Kanada, Australi, Argjentinë, etj. është shumë e gjërë dhe e komplikuar, prandaj ajo mund t'i bëhet e njohur lexuesit shqiptarë vetëm nëpërmjet botimeve seriale enciklopedike.

Në të gjitha kohërat është folur për Diasporën Shqiptare, por fatkeqësisht ky emër i bukur e kuptimplotë ka mbetur kurdoherë vetëm një slogan, që është përdorur vazhdimisht nga

qeveritarët e politikanët shqiptarë të të gjitha ngjyrave për qëllime propagandistike në situata të caktuara kalimtare historike.

E themi këtë për arsye se, ndonëse flitet vazhdimisht për Diasporën Shqiptare, e cila, pa asnjë dyshim, ka luajtur një rol të veçantë për emancipimin e Shoqërisë Shqiptare, në të vërtetë ajo nuk njihet sa dhe si duhet, pasi deri tani nuk ka botime përgjithësuëse të mirëfillta, ku të tregohet me fakte e statistika zyrtare, se sa shqiptarë ka në këtë apo atë vend, cilat kanë qenë ngulimet e para, historia e themelimit të kolonive më të vjetra dhe evolimi i tyre deri në ditët e sotme, pozita shoqërore, personalitetet që kanë dalë nga gjiri i tyre, dhe, jo vetëm ato politike e letrare, por edhe biznesmenë të mirënjohur, si, fjala vjenë, shumë i nderuari Anthony Athanas në Boston, Massachusetts, jeta dhe vepra e të cilit është një shëmbull i shkëlqyer frymëzimi e inkurajimi për brezat e sotëm, por pse jo edhe për ata që do të vijnë.

Kanë qenë pikërisht këto ide dhe mendime që na kanë shtyrë t'i futemi punës për botimin e ciklit: **"SERIA E BOTIMEVE ELITE: DIASPORA SHQIPTARE"**, gjë për të cilën jemi të ndërgjegjshëm se kemi marrë përsipër një barrë tepër të rëndë, që, për momentin, është pothuajse e papërballueshme. Megjithatë, ajo që na bën optimist e të guximshëm ka të bëjë me faktin se, së pari, jemi të bindur se kemi marrë një vendim të drejtë që nuk mund e nuk duhet shtyrë më në kohë; dhe,

së dyti, se për realizimin e kësaj inisiative, në mos sot, nesër, do të kemi mbështetjen e të gjithë bashkëatdhetarëve si dhe të mjaftë krijuesve e kolegëve tanë, që ndajnë me ne të njejtat mendime e aspirata për Diasporën Shqiptare.

Projekti **“SERIA E BOTIMEVE ELITE - DIASPORA SHQIPTARE”**, i ideuar dhe prezantuar nga Shtëpia Botuese Elite qysh në vitin 1998, synon që, në fazën e parë: **(1) të bëhet historia e Kolonive më të vjetra Shqiptare në SHBA**, dhe, në të njejtën kohë, **(2) të dëshmohet se si Diaspora Shqiptare, historikisht, që nga vitet 1890’ dhe deri në ditët e sotme, ka ndikuar në forma e mënyra të ndryshme për emancipimin dhe zhvillimin e Shoqërisë Shqiptare.**

Kanë kaluar tashmë më tepër se gjashtë vjet nga dita kur u ideua ky Projekt, dhe, tashmë mund të themi se, Libri i Parë, **“KOMUNITETI SHQIPTARO-AMERIKAN NE KONEKTIKAT”**, që do të hap këtë seri botimesh, është **i përfunduar**, pra, gati për të shkruar në shtyp.

Libri ka rreth 600 faqe, është përgatitur në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht, ka rreth 502 ilustrime me ngjyra: 409 foto; 64 piktura dhe vepra të tjera arti; 16 tabela informative; 13 fotomontazhe, 80 e ca intervista me personalitete e individë të veçantë nga Diaspora Shqiptare, reklama të ndryshme apo ilustrime të tjera

me ngjyra.

Sikurse vihet re, gjatë punës tonë kërkimore në Bridgeport, Hartford dhe Waterbury, ku janë vendosur qysh në vitet 1890’ e më pas tre ngulime nga më të vjetrat me mërgimtarë shqiptarë, kemi përdoruar të gjitha mënyrat e mundshme për hulumtime. Megjithatë, për ta paraqitur realisht gjendjen në ditët e sotme, sidomos në qytete si Hartford-i, ku vetëm gjatë viteve të fundit janë vendosur më tepër se 1500 familje shqiptare, mënyra më e mirë për të komunikuar me lexuesit shqiptarë, është bashkëbisedimi i hapur nëpërmjet intervistave me synime të caktuara, bisedat e shkurtra, komentet dhe opinionet e individëve të veçantë për jetën në mërgim.

Kjo është një punë që, gjithsecili mund ta bëjë fare lehtë nëse dëshiron, dhe, nëse vendos të marrë në dorë një laps dhe një copë letër të bardhë, ashtu sikurse vepron kur ulet për t’u shkruar njerëzve të tij të dashur, shokut apo mikut, që ka lënë në Shqipëri. Çfarë duhet shkruar konkretisht? Edhe për këtë nuk duhet vrarë mendja aq shumë, pasi këtu më poshtë kemi radhitur 24 pyetje orientuese, të cilave mund t’u përgjigjeni ashtu sikurse dëshironi, gjatë dhe duke i marrë sipas radhës, ose, **fare shkurt, sa për të dhënë një opinion ose për të bërë një koment për një problem të caktuar.**

INTERVISTA -
PYETJE ORIENTUESE: 1. Largimi

juaj nga Shqipëria ishte një rastësi, një lëvizje e imponuar nga rrethana të caktuara, apo thjeshtë një dëshirë për të bërë një jetë më të mirë? 2. A e patët të vështirë për të marrë një vendim të tillë, nëse "po" përse? 3. Si e keni ndjerë veten në çastin kur zbritët për herë të parë në tokën amerikane? Çfarë iu bëri më tepër përshtypje? 4. Cilat ishin vështirësitë e ditëve të para: banesa, gjuha, puna? 5. A keni patur vështirësi për të komunikuar në gjuhën angleze? Si e keni zgjidhur këtë problem? 6. A jeni e (i) kënaqur nga puna që bëni: kushtet, pagesa, e përshtatshme ose jo për profesionin apo natyrën tuaj? 7. Arsimimi & kualifikimi: a ka hapësira të nevojshme që të hapin rrugën për të ecur përpara? Si bëhen aplikimet për të vazhduar shkollën e mesme apo të lartë, kushtet dhe karakteri i tyre? 8. A jeni ndier ndonjëherë e (i) diskriminuar për shkak të kombësisë apo shtetësisë shqiptare? 9. Cilat janë arritjet tuaja më të mira gjatë kohës në emigracion? 10. A jeni e (i) kënaqur me gjithçka që keni arritur? Planet tuaja për të ardhmen? 11. A jeni e (i) kënaqur nga jeta në Amerikë? Nëse përgjigja juaj është "po", përse? Dhe, nëse përgjigja juaj është "jo", përse? Çfarë ju mungon? 12. A keni dëshirë të vizitoni Shqipërinë? Nëse përgjigja juaj është "po", përse? Dhe, nëse përgjigja juaj është "jo", përse? 13. A e keni ndjerë ndonjëherë veten disi fajtor për braktisjen vendlindjes, ku tashmë ndodhen njerëzit tuaj më të dashur, shokët apo miqtë, me të

cilët shoqëroheshit çdo ditë dhe kuvendonit për të mirat e të këqijat e shoqërisë shqiptare? 14. A keni dëshirë të riktheheni në Shqipëri? Nëse "po", përse, çfarë ju shtyn të ndërmerrni një veprim të tillë? Nëse "jo", përse, a nuk ndjeni dhimbje kur jeni larg vendlindjes tuaj, të ndarë nga njerëzit tuaj më të afërt që ju kanë dashur dhe ju duan aq shumë? 15. Çfarë njerëzish keni lënë në Shqipëri? Si komunikoni me njeri-tjetrin? Çfarë ju shqietëson më shumë: problemet familjare apo problemet që shqetësojnë vendin? 16. A keni plane për tërhequr në SHBA njerëzit tuaj më të afërt? Përse e keni marrë një vendim të tillë? A është kjo thjeshtë dëshira juaj, apo ndodheni nën presionin e tyre? Arsyet? 17. A keni patur ngjarje të rëndësishme në jetën tuaj në SHBA? Tregoni raste që ju kanë bërë më shumë përshtypje dhe që ju kanë lënë mbresa të veçanta? Diplomime? Fejesa? Martesa? 18. Së fundi, le të bëjmë, si mund të themi, një llogari: a) Çfarë keni fituar ose çfarë shpresoni se do të fitoni në të ardhmen, duke qendruar në SHBA? Tregoni disa gjëra konkrete, të prekshme? b) Çfarë keni humbur ose çfarë mendoni se do të humbisni në të ardhmen, duke qendruar në SHBA? 19. A rrezikohet identiteti kombëtar? Shkurt: a keni dëshirë ta quani veten shqiptar? Çfarë mendon sidomos brezi i ri në lidhje me këtë çështje? A flisni shqip në familje? A kanë dëshirë fëmijët të mësojnë gjuhën shqipe? A ju pëlqejnë manifestimet sipas traditave e zakoneve shqiptare? Sipas mendimit tuaj, si fillon

proçesi i ftohjes me vendlindjen, ose, sikurse mund të quhet ndryshe, vendi i origjinës, për ata që kanë lindur jashtë Atdheut? Çfarë harrohet në fillim: gjuha, pastaj traditat e zakonet, e kështu me radhë? 20. Çfarë dëshironi t'u thoni bashkëatdhetarëve që aktualisht jetojnë në Shqipëri? A duhet të ndjekin rrugën e emigrimit? 21. Sipas mendimit tuaj, në një botë të civilizuar, a mund të konsiderohet si një gjë normale fenomeni i emigrimit? Nëse "po", përse, çfarë të mira i sjellë ai vendit si dhe familjeve e njerëzve tuaj më të afërt? Nëse "jo", përse, çfarë të këqija i sjellë ai vendit si dhe familjeve e njerëzve tuaj më të afërt? 22. Çfarë duhet të bëjë Shteti Shqiptar për të ruajtur lidhjet si dhe për të komunikuar në mënyrë sistematike me Diasporën Shqiptare? 23. A mund dhe a duhet të jap ndihmesën e tij Shteti Shqiptar për integrimin tuaj në Shoqërinë Amerikane? Nëse "po", në ç'drejtime do ta dëshironit ndihmesën e tij, dhe, në ç'formë e me çfarë mjetesh efikase? 24. Nëse dëshironi, mund të jepni opinione edhe për çështje apo probleme që nuk janë prekur në pyetjet e sipërmendura, ashtu sikurse mund të mos jepni përgjigje për ato pyetje që mendoni se nuk keni ndonjë gjë për të thënë, ose, thjeshtë, sepse nuk dëshironi të jeni e (i) angazhuar. Faleminderit.

Materialin e përgatitur mund ta dërgoni në Via E-mail:

info@elitelibri.com;
anasi@elitelibri.com;

ose me postë në adresën:

**Shtëpia Botuese Elite, P. O.
 Box: 8293, Tiranë, Albania.**

PS: Më poshtë do të radhitim tërë ata persona shumë të nderuar, që do të na japin mendime, komente, opinione dhe intervista të vlefshme për botim në kapitullin:

"Bashkëbisedim i hapur me lexuesit shqiptarë për jetën në mërgim", gjë që do të përpiqemi ta realizojmë së bashku nëpërmjet kontakteve tona të drejtpërdrejta, në Via E-mail, si dhe nëpërmjet postës, duke shfrytëzuar adresat e sipërmendura.



**WILLIAM N
 JOHNS** (Vasil KAMENICA)

Unë kam lindur në Korçë, por baban e kam nga Kamenica, kurse mamanë nga Floqi. Kur më pyesin: "nga je?", unë them gjithmonë, jam nga Kamenica e Korçës. Këtu në Uster (Worcester) kemi ardhur në vitin 1938 dhe gjithnjë kemi punuar për shqiptarizëm. Bashkë me Z. Thanas Laska kemi shkuar shpesh herë në Shqipëri për të mbajtur gjallë ndjenjat tona kombëtare.

Tani këtu në Uster kanë ardhur shumë shqiptarë dhe mund të them se duhet të jenë bërë rreth 12.000 persona, kurse dikur kemi patur rreth 2000 persona. Sipas mendimit tim, Komuniteti Shqiptar në Uster është ndoshta më i madhi në të gjithë Amerikën. Edhe në Nju Jork ka shumë shqiptarë, por nuk janë të organizuar në një komunitet sikurse jemi ne këtu në Uster, i cili është një qytet me 175.000 banorë. Shumë shqiptarë ka edhe në Boston, po ashtu edhe në Sauthuiç. Në Netik ka gjithashtu shqiptarë, të cilët kanë ndërtuar prej kohësh edhe një kishë të vogël, që i mban njerëzit të bashkuar e të organizuar si një komunitet më vete. Netika është një vend i vogël, që ngjan më tepër si një fshat, dhe ndodhet rreth 20 milje nga Bostoni dhe 25 milje nga Usteri. Edhe në Sauthuiç ka gjithashtu një kishë që i mban njerëzit të bashkuar, por këtu nuk ka edhe aq shumë shqiptarë se qyteti është i vogël: ka gjithësej rreth 15.000 banorë.

Me shqiptarët që banojnë në Netik, po ashtu edhe në Sauthuiç, ne bëjmë shumë gjera bashkë, mblidhemi me rastin e festive të ndryshme, vemë e vijmë tek njeri tjetri, e kështu me radhë. Në Netik ka sidomos shqiptarë të vjetër, tani nuk kanë shkuar më të rinj sepse është vend i vogël dhe nuk ka as punë, kurse në Sauthuiç jeta është më ndryshe.

Shqiptarët që kanë ardhur në këto vitet e fundit janë kryesisht nga Tirana, sepse është qytet i madh dhe tani aty po mblidhet e gjithë

Shqipëria, por kur i pyesim se nga e kanë origjinën, ka shumë nga ata që thonë se janë nga Korça si dhe qytete e krahinat e tjera të këtij rajoni. Edhe shqiptarët e vjetër, që janë vendosur prej kohësh me banim këtu në Uster, janë kryesisht nga Korça dhe nga Përmeti. Kuptohet si nga qyteti, po ashtu edhe nga fshatrat e Korçës apo të Përmetit.

Shqiptarët e parë këtu në Uster, po ashtu edhe në këto vendet e tjera këtu afër, kanë ardhur për herë të parë aty nga vitet 1904-1905. Gjyshi im p.sh. ka ardhur në vitin 1904. Kurse në Boston kanë ardhur edhe më përpara, ndoshta qysh nga vitet 1890'.

Kisha jonë këtu në Uster është sot 93 vjeçare dhe në vitin 2005 ka 95 vjetorin dhe ne kemi menduar të festojmë të Shtunën e Madhe. Megjithatë, kjo nuk është kisha më e vjetër shqiptare. Kisha më e vjetër shqiptare është në Boston. Jo kjo që quhet tani Kisha e Shën Gjergjit, por ka qënë një kishë tjetër me të njëjtin emër që është djegur. Ajo ka qënë kisha më e vjetër shqiptare në këtë rajon, e cila është drejtuar nga Fan Noli.

Shqiptari parë që është vendosur në këtë rajon ka qënë një prift, i cili nga sa më kujtohet, quhej Kristofor (Christopher) dhe, nga sa di unë, ka ardhur këtu para vitit 1900. Unë nuk mund të them se në cilin vit konkretisht, por për këto gjëra ne kemi dokumentet e kishës dhe aty duhet parë me qëllim që të jemi sa më të saktë. (Sipas gazetës Iliria, Kol Kristofor, është shiptari i

parë që ka ardhur nga Shqipëria në Amerikë në vitin 1886).

Sidoqoftë, shqiptarët e parë, kudo që janë vendosur në Amerikë, në Boston, Bridgeport apo në ndonjë vend tjetër, tokën amerikane e kanë shkelur për herë të parë në Ellas Ajland (Ellis Island), pra, në Nju Jork, sepse atëhere vetëm aty lejohej hyrja dhe kryeheshin veprimet e nevojshme.

Në Ellas Ajland ndodhet një muzeum shumë i madh dhe i bukur, ku mund të gjenden të dhëna shumë interesante edhe për shqiptarët, pasi aty janë të rregjistruar të gjithë personat që hynin atëhere në Amerikë. Vetëm se është mirë që të dish përafërsisht ditën se kur ka hyrë personi për për të cilin jeni i interesuar, sepse personat rregjistruar janë shumë, të ardhur nga të gjithë vendet e botës.

Pra, shqiptarët në ato kohëra, kur vinin në Amerikë, ishin të detyruar të zbrisnin në Ellas Ajland - Ellis Island (Nju Jork) dhe pastaj shpërndaheshin dhe vendoseshin nëpër qytete e vende të ndryshme. Në ato kohëra qytetet që preferoheshin më shumë ishin Nju Jorku dhe Bostoni, pastaj filluan të vendosen edhe nëpër qytete të tjera si Uster, Brixhport, e kështu me radhë. Kuptohet, vendosja e tyre në këtë apo atë vend bëhej sipas rekomandimeve që u jepnin familjarët, të afërmit apo shokët e miqtë që kishte njeri apo tjetri, sepse ishin po këta persona që i mbështesnin fillimisht për t'i strehuar apo për t'u gjetur punë. E

njëta gjë ndodhë pak a shumë edhe sot, vetëm se tani shqiptarët i gjenë në të katër anët e Amerikës.

Atdhedashuria është një çështje që varet në radhë të parë nga çdo individ, por në të njëjtën kohë duhet thënë se edhe mënyra e organizimit të shqiptarëve, bashkimi dhe afrimi i tyre me njeri tjetrin, lozin një rol të madh në këtë drejtim. Kështu, nëse ne nuk do të kishim patur kishën tonë këtu në Uster, nuk do të ishim kaq të bashkuar dhe të afërt me njeri tjetrin. Kisha na ka bashkuar sepse aty mblidhemi vazhdimisht, sipas një kalendari të caktuar, në ditë e caktura, dhe, kryejmë shërbimet e duhura fetare, por në të njëjtën kohë qajmë edhe hallet me njeri tjetrin, kuvendojmë, zgjidhim problemet që na shqetësojnë, shkëmbejmë mendime dhe lajme të mira që vijnë nga Shqipëria.

Që të jemi realist, shqiptarët nuk janë fetarë, në kuptimin e vertetë të kësaj fjale, por ata e kanë ndjerë kurdoherë nevojën për të shkuar në kishë edhe për arsyet që përmenda më sipër. Një shembull i qartë për këtë janë shqiptarët e ardhur këtu në Uster në këto vitet e fundit, të cilët sikurse e theksova edhe më sipër, po arrijnë dalë nga dalë shifrën 10.000 banorë. Për këta nuk mund të thuhet se janë fetarë të mëdhenj, pasi dihet se janë rritur dhe edukuar në një regjim ateist, pra, praktikisht iu mungon edukata fetare, por është po kaq i vërtetë fakti që, shumica e tyre, për të mos thënë pothuajse të gjithë kërkojnë të bëhen anëtarë të kishës sonë, dhe ne i kemi

pranuar, pavarësisht se në përgjithësi nuk kanë qenë në gjendje që të paguajnë kuarën vjetore të anëtarësisë që është 500 USD. Dhe këto lëshime i kemi bërë me qëllim që të mblidhemi të gjithë bashkë dhe të qendrojmë pranë njeri tjetrit, ta duam dhe ta ndihmojmë njeri tjetrin, dhe, kryesorja, të mos harrojmë asnjëherë se nga kemi ardhur.

Shqipërinë gjithsecili duhet ta ketë kurdoherë në mendje e në zemër, sepse është Atdheu ynë ku kanë lindur dhe janë rritur të parët tanë, dhe, ku kemi sot e do të edhe në të ardhmen, njerëzit më të dashur, prindërit, vëllezërit e motrat, si dhe gjithë të afërmit e tjerë, apo shokët e miqtë e paharruar. Ja, sepse atdhedashuria është një ndjenjë e shtjnjtë, që duhet të edukohet e rrënjohet në ndërgjegjen e gjithsecilit, në radhë të parë, nëpërmjet punës që bëhet në çdo familje, e pastaj edhe nëpërmjet punës që bëjnë institucionet fetare, si kisha, apo shkolla, shoqatat e ndryshme sociale-kulturore, e kështu me radhë.

Megjithatë, në këtë drejtim, rolin kryesor e ka luajtur kurdoherë kisha, sepse është pikërisht kisha ajo që na bashkon realisht dhe edukon ndjenjat e atdhedashurisë. Nëse nuk do të kishim kishën, nuk do të ishim në gjendje që të mblidheshim herë pas here bashkë me njeri tjetrin dhe të kryenim aktivitete të ndryshme fetare, sociale dhe kulturore. Këtu çdo veprimtari, e çdo karakteri qoftë, organizohet nga kisha dhe

pjesmarrja është e kënaqshme, pasi vijnë shqiptarë edhe nga qytete e vendbanime të tjera, si: Sauthuiç, Netika, pse jo edhe nga Hartford-i, apo Bostoni. Ka raste që këtu mblidhen edhe 20.000 persona. Nëse nuk do të ishte kisha, nuk kishte se si të mblidheshin kaq shumë shqiptarë, nuk kishte sesi të ruhej dhe edukohet në zemrat e tyre ndjenja e atdhedashurisë, apo ndjenja e dashurisë dhe e respektit për njeri tjetrin.

Një rëndësi të posaçme i kemi kushtuar gjithmonë ruajtjes të rriteve e zakoneve shqiptare, si në raste gëzimi, sikurse janë: fejesat, dasmat, festat e ndryshme fetare apo kombëtare, po ashtu edhe në raste hidhërimi, sepse jeta i ka edhe këto gjëra. Megjithatë, ruajtja e gjuhës shqipe me të gjitha format e mënyrat, ka qenë kurdoherë preokupacioni ynë kryesor. Sikurse e pamë edhe pak më parë, në këtu pranë kishës kemi hapur edhe një shkollë për mësimin e gjuhës shqipe, e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme: me klasa moderne, banka, tabela dhe orendi të tjera, shumë të nevojshme për të dhënë mësim dhe për të bërë që fëmijët tanë të ndjehen mirë dhe të shkojnë me shumë dëshirë për të mësuar gjuhën amtare apo ritet e zakonet e të parëve të tyre.

Në këtë drejtim, dua të them për ruajtjen e gjuhës shqipe, shkolla ka bërë vazhdimisht një punë të mbrekullueshme, dhe, për këtë arsye Komuniteti Shqiptar, si këtu në Uster, po ashtu edhe në qytete

e vëndbanime të tjera fqinje ku ka shqiptarë, nuk janë kursyer asnjëherë, por kanë bërë investime të lavdërueshme. Megjithatë, krahas shkollës, një punë shumë e mirë për mësimin dhe ruajtjen e gjuhës shqipe, sidomos tek brezi i ri, pra, tek fëmijët tanë, që lindin dhe rriten në tokën amerikane, kanë bërë kurdoherë dhe vazhdojnë të bëjnë edhe në ditët e sotme, vetë familjet shqiptare, përndryshe shkolla shqipe do ta kishte shumë të vështirë të mbante vazhdimisht gjallë gjuhën amtare, pasi sukurse dihet, fëmijët tanë këtu shkojnë në shkolla amerikane, ku mësimi dhe të gjitha lëndët bëhen në gjuhën angleze.

Ruajtja dhe mbajtja gjallë e gjuhës shqipe, nuk është problem vetëm për fëmijët tanë, por edhe për të rriturit prandaj sa herë që mblidhemi bashkë, kur takohemi nëpër klube për të pirë një kafë, kur shkojmë për vizitë tek njeri tjetri, apo sa herë që shkojmë në kishë, kuvendojmë në gjuhën shqipe, po kështu edhe shërbimet fetare në kishë apo kudo gjatë kryehen në gjuhën shqipe, sepse kisha jonë Saint Mary's Assumption Albanian Orthodox Church - Kisha Ortodokse Shqiptare Fjetja e Shën Marisë, sikurse duket edhe nga emri që mban, është kishë ortodokse shqiptare e krijuar në vitin 1910.

Priftërinjtë në kishën tonë janë shqiptarë, po kështu edhe prindërit e tyre janë me origjinë shqiptare, kështu që ata i kryejnë shërbimet fetare kurdoherë në gjuhën shqipe, me qëllim që njerëzit ta ndjejnë

gjithmonë veten shqiptarë, dhe, këtë gjë ta pranojnë hapur, të thonë sa herë që i pyesin se, janë shqiptarë, dhe, jo si dikur që, thoshin "*I'm from Albania*", por në ato kohëra këtu në Amerikë nuk e dinin fare se nga binte Shqipëria, kurse sot e dinë, dhe, neve na vjen shumë mirë kur themi se jemi shqiptarë. Kur bisedojmë ngandonjëherë me këta që janë amerikan dhe u themi se, "do të shkojmë në Kishën Fjetja e Shën Marisë - Saint Mary's Assumption", na shikojnë me habi sepse nuk na kuptojnë, por kur ju themi se do të shkojmë në Kishën Shqiptare, reagojnë menjëherë dhe na thonë: "Ah, po! Kisha Shqiptare është në Sauthuiç!" dhe na kuptojnë menjëherë sepse e dinë shumë mirë që kjo është Kishë Shqiptare. Kuptohet, neve na vjen shumë mirë në këto raste, sepse na vlon përbrenda ajo ndjenja e krenarisë kombëtare, dhe, kjo është një gjë shumë e rëndësishme. Asnjëherë nuk duhet të harrojmë se jemi shqiptarë, pavarësisht se jemi me pasaportë amerikane dhe flasim kudo anglisht, pasi këtë gjë e do puna, jemi në mërgim në një vend që, realisht nuk është vendi ynë, por nga mënyra sesi jemi pritur e trajtuar këtu në Amerikë, në të gjitha kohërat, si dikur, por edhe në ditët e sotme, me të drejtë duhet të themi se "Amerika është Atdheu ynë i dytë!". Kjo është e vërtetë dhe askush nuk gabon kur e pranon hapur këtë gjë, pasi nëse duam të jemi realist, këtu në Amerikë, shqiptarët nuk janë ndjerë asnjëherë të diskriminuar vetëm për faktin se "janë shqiptarë", sikurse ndodhë, fjala

vjen, në shumë vende të civilizuar europiane, pa folur më pastaj për vendet fqinje ku fjala "shqiptar" ju duket tepër alergjike.

Ja, këto janë arsyt pse ne shqiptarët këtu në Uster, bashkë me shqiptarët që jetojnë në Netik apo Sauthuiç, me të cilët formojmë një Komunitet Shqiptarë, që ka një emër të nderuar, përpigemi vazhdimisht që të mbajmë gjallë ndjenjat tona kombëtare, të ndjehemi krenar që jemi shqiptarë, por në të njëjtën kohë të luftojmë që gjithsecili nga ne, të bëjë kurdoherë një jetë korrekte, në radhë të parë, në përputhje me ligjet amerikane, por pa cënuar asnjëherë edhe normat morale dhe etike të komuniteteve të tjera, sepse kjo do të cënonte pastaj marrëdhëniet e shkëlqyera që kemi patur historikisht këtu në Uster, dhe që, na vjen mirë të themi se, edhe në ditët e sotme, kur mendohet se këtu mund të kenë ardhur rreth 10.000 shqiptarë të tjerë pas vitit 1991 e këtej, vazhdojmë të jemi përsëri njerëz të nderuar e respektuar si nga administrata dhe organet e specializuara shtetërore, po ashtu edhe nga popullsia vendase.

Unë kam tre fëmijë: dy vajza dhe një djalë, dhe, me këtë rast dua të them se, të dyja vajzat janë martuar me shqiptarë. Nuk u jemi imponuar për të marrë një vendim të tillë, kjo ishte thjeshtë një dëshirë e tyre, që, sigurisht, përputhej me dëshirën e gjithë families tonë, pasi gjithmonë kemi menduar se, është më mirë që familjet e reja shqiptare të krijohen

brenda për brenda komunitetit tonë sepse merremi vesh më mirë, por njëkohësisht duke vepruar kështu, ruajmë mirë traditat dhe zakonet tona kombëtare. Sigurisht, kjo nuk do të thotë aspak se, martesat e lidhura me komunitet e tjera janë të gabuara. Ja, përshebull, djali im nuk është martuar me një vajzë shqiptare, por ne prapëseprapë shkojmë shumë mirë dhe e duam njeri tjetrin. Tani unë kam 8 nipër e mbesa, që i dua shumë dhe më bëhet qejfi kur i shikoj që shkojnë në shkollën tonë dhe mësojnë gjuhën shqipe. Përse? Sepse dikur ne nuk i kishim këto kushte që u kemi krijuar nipërve e mbesave tona sot, pasi prindërit tanë nuk kishin arritur deri aty sa të na hapnin një shkollë shqipe si kjo që kemi sot, dhe, ngaqë ishin të angazhuar me shumë punë, në kohën tonë familja nuk bënte këtë punë që bëjmë ne sot për mësimin e gjuhës shqipe dhe edukimin e ndjenjave kombëtare.

Kur ishin ende gjallë prindërit tanë, në familje flitej shqip, dhe, kështu, në ato kohëra brezi ynë i dytë mësonte ndonjë fjalë shqip, por pasi ata vdiqën shqipja filloi të harrohej fare. Kjo bëri që shumë djem e vajza nga brezi i ynë, dhe, më shumë akoma, fëmijët tanë, domethënë, brezi i tretë, filluan ta harronin gjuhën shqipe, dhe, kur takoheshin me ne që e dinim gjuhën shqipe, (sepse si unë po ashtu edhe gruaja ime që është nga Drenova e Korçës, e kemi ditur gjithmonë shumë mirë gjuhën shqipe), iu vinte turp ngaqë nuk dinin të shkëmbenin asnjë fjalë

shqip, pasi flisnin vetëm anglisht dhe praktikisht ishin bërë amerikan.

Megjithatë, edhe pse nuk flitej më gjuha shqipe në disa familje apo nga disa individë të veçantë, ata vazhdonin ta ndjenin veten shqiptarë dhe e donin Shqipërinë. Në mërgim mund të ndodhë që për arsye të ndryshme, që, në fund të fundit, nuk kanë të bëjnë me dëshirën e individit, gjuha amëtare edhe mund të harrohet, por nuk mund të harrohet kurrsesi prejardhja, origjina, pra, Atdheu. Këtu në Amerikë mund të gjeshë sot familje me origjinë shqiptare që nuk dinë të flasin asnjë fjalë shqip, por nëpër muret e shtëpive të tyre gjen të varur flamurin shqiptar, ndonjë bust të Skënderbeut, e kështu me radhë, ç'ka do të thotë se në mëndjen dhe zemrat e tyre vazhdon të jetojë dhe është ende e gjallë ndjenja kombëtare, ajo që ne shpesh herë e quajmë shqiptarizma.

Nëse do t'i radhisnim tërë ata elementë që përbëjnë dhe mbajnë gjallë ndjenjën kombëtare, si: gjuha, ritet, zakonet, mitet e kështu me radhë, është pikërisht gjuha ajo që fillon të humbasë e para, të tjerat mbeten dhe rrojnë në mendjet dhe zemrat e njerëzve për një kohë relativisht të gjatë. Kështu, përshëmbull, s'harrohet kurrë prejardhja, origjina e familjes, që, dashur padashur të çojnë tek Mëmëdheu.

Sikurse e theksova edhe pak më lartë, marrëdhëniet me njeri tjerin brenda për brenda komuniteteve

shqiptare, por edhe jasht tyre, me komunitet e tjera, i kemi patur kurdoherë shumë të mira. Në këtë drejtim kemi punuar vazhdimisht, sepse e ndjejmë se shqiptarët kudo që jetojnë këtu në Amerikë, është mirë që të mbajnë lidhje me njeri tjetrin, ashtu sikurse mbanin dikur nëpërmjet punës së madhe që bënte dikur Shoqëria Panshqiptare Vatra, e cila në ato kohëra kishte një organizim të përkryer, dhe, për këtë arsye, atëhere Diaspora Shqiptare në Amerikë ishte më e bashkuar. Megjithatë, edhe sot ne përpigemi të ruajmë disa lidhje, sidomos me komunitet shqiptare që kemi më afër. Kështu, përshëmbull, rreth 70 persona nga Usteri shkojnë vazhdimisht në Kishën e Bostonit, sa herë që ka manifestime të rëndësishme fetare. Sigurisht, mund të shkonin edhe më shumë, sepse komuniteti ynë shkon shumë mirë me komunitetin shqiptar të Bostonit, por çështja është se, ndonëse Kisha e Bostonit mban rreth 1200 persona, njerëzit nuk kanë se ku të hanë drekën pasi tek Anthony Athanas mund të drekjojnë rreth 400 persona.

Nërmjet komuniteteve të tjera, që janë në shumicë këtu në Uster, mund të përmendim në radhë të parë greket, këtu ka vërtet shumë grekë, pastaj vijnë irlandezët, francezët, polakët, lituanëzët, spanjollët, ka shumë çifutë gjithashtu, të cilët dikur përbënin shumicën, ishin gati 10.000 persona, por pas dyndjeve të shqiptarëve në këto vitet e fundit, për të cilët themi gjithmonë se duhet të kenë arritur në 12.000

persona, jemi ne sot komuniteti më i madh në Uster. Kështu që, tani shtrohet problemi se si duhet të bashkohemi si një familje e madhe, të njihemi me njeri tjetrin dhe të ndihmojmë e përkrahim ata që kanë nevojë, pasi jeta në mërgim ka vështirësitë e veta. Kur erdhi këtu në Uster këngjështarja e mirënjohur drenovare, Eli Fara, për të dhënë një koncert, në sheshin para kishës tonë ishin mbledhur rreth 5.000 veta, ç'ka do të thotë se po të gjinden forma e metoda pune efikase, shqiptarët këtu mund të bashkohen e të lidhen me njeri tjetrin.

Këtu në Uster kemi edhe një Radio Shqiptare, që mban emrin "Ora Shqiptare", e krijuar para 60 vjetëve dhe që ka bërë një punë shumë të mirë për informimin dhe bashkimin e shqiptarëve.

Nëpërmjet kësaj radioje, jepen vazhdimisht lajme nga Shqipëria, gjë për të cilën Komuniteti Shqiptar këtu në Uster është shumë i interesuar, po kështu transmetohen kronika të ndryshme, njoftime për ngjarje familjare, si: martesë apo vdekje, njoftohet cili u nis për të shkuar në Shqipëri dhe cili u kthye prej andej, transmetohen komentet apo intervistat që ata japin për gendjen në Shqipëri, e kështu me radhë. Kjo radio transmeton në gjuhën shqipe vetëm një herë në javë, të shtunave, nga ora 20.00 - 23.30.

Në këto vitet e fundit kemi dëgjaur që, këta të rinjtë që kanë ardhur nga Shqipëria kanë hapur një radio të re që transmeton në gjuhën shqipe, por nuk e dimë se ku ndodhet dhe cili është ky person që

e ka hapur. Flitet se ka punuar në Radio Tirana, dhe, disa nga emisionet që kemi ndjekur na janë dukur shumë të mira, por nuk e kapim gjithmonë sinjalin e kësaj radioje. Ndërsa përsa u përket gazetave mund të them se, ne kemi patur gazetën tonë që prej 50 vjetësh, por që kur vdiq Dhimitër Trebicka vdiq edhe gazeta jonë.

Kjo bisedë e lirë u zhvillua në muajin Nëntor 2003 nga: Apostol Nasi, Shkrimtar & Botues



PANDI MANÇO, mësues nga Drenova e Korçës

(Intervista: shpresojmë se do të jetë gati së shpejti)

Të nderuar bashkëatdhetarë me banim në Worcester,

Lutemi, edhe njëherë: Merrni pjesë në rubrikën "**Bashkëbisedim i hapur me lexuesit shqiptarë për jetën në mërgim**", duke dërguar me shkrim **mendimet, opinionet apo komentet** Tuaja në adresën e Shtëpisë Botuese Elite Tiranë.

Përsëndetje,
Apostol NASI
Shkrimtar & Botues